



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri
Mbledhja nr. 30
Prishtinë, më 17 Qershor 2009
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225
Mbledhja filloi në orën 13:00

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri

Morën pjesë: Rustem Mustafa, Shkumbin Demaliaj, Emrush Xhemajli, Eqrem Kryeziu, Gani Geci, Agim Veliu, Zafir Berisha dhe Zylfi Merxha.

Munguan: Bojan Stojanović, Melihate Termkollli dhe Ibrahim Selmanaj.

Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë: Nur Çeku, Antigona Ibraj, Blerina Pula dhe Nuredin Ibishi

Mbledhjen e kryesoi: Rustem Mustafa, kryetari i komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit të datës **26.05.2009**
3. Shqyrtimi i projektligjit për armët
4. Shqyrtimi i projektligjit për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike
5. Të ndryshme

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të datës 26.05.2009

Procesverbali i datës 26.05.2009 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i projektligjit për armët

Kryetari i Komisionit – tha, referues i projektligjit për armët ka qenë Shkumbin Demaliaj dhe ia jap fjalën që të na njoftoj në lidhje me rekomandimet.

Shkumbin Demaliaj – Pasi që, nga grupi punues është shqyrtuar projektligji për armët, është bërë raporti me amendamentet e propozuara, të cilin ia kemi sjellë komisionit për shqyrtim.

Z.Shkumbin Demaliaj filloi ti prezantoi të gjitha amendamentet. Në amendamentin e 4 neni 7 paragrafi 1, z. Agim Veliu ka kërkuar që ky amendament të fshihet në tërësi. Pastaj në amendamentin e 6 neni 7, z. Eqrem Kryeziu ka kërkuar që të zëvendësohet fjala përfshin me fjalën përfshijë. Në amendamentin 6 neni 7 z.Emrush Xhemajli, ka kërkuar të fshihet fjala aktiv. Në amendamentin 18 neni 45 lidhëza “apo” zëvendësohet me lidhëzën “dhe”. Gjithashtu edhe në amendamentin e 19 lidhëza “apo” zëvendësohet me lidhëzën “dhe”.

Anëtarët e komisionit miratuan me vërejtjet e propozuara, raportin me rekomandime për projektligjin për armët.

4. Shqyrtimi i projektligjit për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike

Kryetari i Komisionit – tha, deputeti Gani Geci ka qenë referues në këtë projektligj të cilit ia jap fjalën për të paraqitur raportin me propozim amendamente.

Gani Geci – Vërejtjet e parashtruara nga deputetët unë i kam nënvizuar, mirëpo gjatë grupit punues sponsoruesit kanë sqaruar dhe kanë qenë më të drejtë.

z. Gani Geci i prezantoi amendamentet. Në amendamentin e 3 neni 8.1 z. Agim Veliu ka kërkuar që të harmonizimi sa i përket orës, të shkruhet në gjithë tekstin 22:00, ose të shkruhet 10:00 e mbrëmjes.

Anëtarët e komisionit miratuan me vërejtjet e propozuara raportin me rekomandime për projektligjin për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike.

4. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit – tha, në këtë pikë unë desha të përmend se me datë 23 qershor do të jetë një seancë ku do të diskutohet për vjedhjen në polici në “Dhomën e Provave”, për të cilën ne si komision kemi bërë rekomandimet tona. Kryesia e Kuvendit ka kërkuar informatë nga Ministri i Punëve të Brendshme z.Zenun Pajaziti dhe ai do të paraqitet në Interpelancë. Unë ju ftoj juve si anëtarë të komisionit që të jeni pjesë aktive në seancë të diskutoni në lidhje me këtë çështje.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00

Përgatiti:

Njësia Mbështetëse e Komisionit

Kryetar i Komisionit

.....
Rrustem Mustafa